

TIRANË, më 26/01/2020

**STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“PROLAB INTERNATIONAL” SH.P.K.**

THEMELIMI, ZOTËRIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, SELIA

Neni 1

Ortakët e Shoqërisë

1.1 Ortakët e shoqërisë janë:

- **Z. Cevat Aybars HEPER**, shtetas turk, lindur më 14.01.1973, në ANKARA/TURQI, banues në Rr. Siri Kodra, Blloku i ish Magazinave Frigoriferike, Ndërtesa Nr. 4, mbajtës i pashportës së Republikës së Turqisë nr. S20587166, i cili zotëron 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë; dhe
- **Z. Yigit KILIÇ**, shtetas turk, lindur më 05.01.1995, në ALTINDAG/TURQI, banues në Rr. Siri Kodra, Blloku i ish Magazinave Frigoriferike, Ndërtesa Nr.4, mbajtës i pashportës së Republikës së Turqisë nr. U 02922150, i cili zotëron i cili zotëron 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë;

Neni 2

Emri

2.1 Emri i shoqërisë është **“PROLAB INTERNATIONAL” SH.P.K.** (më poshtë referuar si **“Shoqëria”**).

Neni 3

Forma Ligjore

- 3.1 Shoqëria ka formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, në përputhje me ligjin për Shoqëritë Tregtare në Republikën e Shqipërisë.
- 3.2 Shoqëria mund të transformohet në një formë tjetër ligjore në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4

Baza ligjore

4.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në përputhje me këtë Statut, Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (referuar më poshtë **“Ligji për Shoqëritë Tregtare”**) dhe çdo dispozitë tjetër të zbatueshme të legjislacionit shqiptar.

Neni 5

Kohëzgjatja e Veprimtarisë

5.1 Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar.

Përktheu nga gjuha shqipe në gjuhën turke:

ALTIN KODRA
Përkthyes Zyrtar
Official Translator

Neni 6

Selia/Adresa e Regjistruar

- 6.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **“Rr. Siri Kodra, Blloku i ish Magazinave Frigoriferike, Ndërtesa Nr. 4, Tiranë, Shqipëri”**.
- 6.2 Administratori mund të krijojë NIPT-e sekondare të Shoqërisë duke respektuar dispozitat përkatëse për këtë qëllim.

Neni 7

Objekti

Objekti kryesor i aktivitetit të Shoqërisë është:

- 7.1 Tregtimi në tregun e brendshëm, import – eksporti i produkteve të tekstilit dhe lëkurës, të të gjitha llojeve të substancave dhe materialeve të pastrimit dhe higjenës të natyrës industriale apo përdorim personal, materiale pastrimi të lëngshëm, në formë pluhuri dhe detergjentë koncentratë për pastrim bizhuterish, sapun i lëngshëm, sapun, zbutës dhe të ngjashme, produkte petro-kimike, të gjitha llojet e librave, revistave, të gjitha llojet dhe materialet e letrave, dokumenteve, mjeteve dhe pajisjeve shkollore. etj, të gjitha llojet e letrës dhe produkteve gjysëm të gatshme të bëra prej letre, të gjitha llojet e produkteve bujqësore dhe shtazore, të gjitha llojet e prodhimeve të detit, të gjitha llojet e produkteve ushqimore, të gjitha llojet e produkteve industriale, produktet e prodhuara në përputhje me dispozitat e të gjitha llojeve të ligjeve minerare dhe rregulloreve të guroreve.
- 7.2 Tregtimi dhe marketingu i mallrave, artikujve dhe produkte të saj brenda vendit, importimi i të gjitha llojeve të gjysmë-produkteve industriale dhe produkteve nga vendet e huaja në mënyrë që të kontribuojë në industrinë e prodhimit në vend, ri-eksportimi i produkteve nëpërmjet përpunimit ose shfrytëzimit të tyre, në cilësinë e kujdestarit ose përfaqësuesit të shoqërive në të cilat marrin pjesë ortakët e shoqërisë ose të firmave të personave të tretë fizikë ose juridikë, në të cilët janë pronarë ortakë, importimi i lëndës së parë, materialeve ose pajisjeve të shfrytëzimit në lidhje me objektin e biznesit të këtyre firmave dhe eksportimi i produkteve të gatshme dhe gjysmë të gatshme të këtyre firmave, në kuadër të parimeve dhe procedurave të kornizës së legjislacionit të tregtisë me jashtë sigurimi i shërbimeve të ndërmjetësimit në varësi të kontratave të prodhuesve dhe furnitorëve në eksportet e kryera me klientët e tyre.
- 7.3 Blerja, shitja, operimi, marrja me qira, dhënia me qira e çdo lloj pasurie të paluajtshme, vendosja e të drejtave ortakërore dhe ato personale mbi to, marrja e hipotekës, dhënia e hipotekës dhe lëshimi i hipotekës për të arritur qëllimin e saj. Mund të krijojë servitut, uzufukt, përgjegjësi për pasuritë e paluajtshme, lënie me ose pa pagesë, lënie për publikun, ndarje, unifikim dhe krijimi të servitutit të dyshemesë dhe të pronësisë së dyshemesë për pasuritë e saj të paluajtshme. Ajo mund të kryejë të gjitha llojet e transaksioneve dhe kursimeve në lidhje me pasuritë e paluajtshme në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të tilla si ndryshimi, ndarja, unifikimi, parcelizimi.

Përktheu nga gjuha shqipe në gjuhën turke:

ALTIN KODRA
Përkthyes Zyrtar
Official Translator



- 7.4 Shitja, blerja, dhënia me qira e një pronë të luajtshme dhe të paluajtshme që mund të konsiderohet e nevojshme. Kryerja e qirasë financiare, dhënia me qira, marrja e çdo lloj huazimi me ose pa siguri, nga brenda vendit dhe jashtë saj. Mund të japë dhe çlirojë të gjitha llojet e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme pajisjet në emër të shoqërisë, në emër të palëve të treta dhe personave juridikë. Mund të marrë hipotekë ose kolateral në këmbim të arkëtive të saj, si një garanci e detyrimeve të saj ose në favor të palëve të treta, mund të japë hipoteka ose peng, të kërkojë anulimin e këtyre hipotekave dhe të japë të gjitha llojet e sigurimeve dhe garancive.
- 7.5 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve sipas kushteve për ndryshimin e Statutit.

Neni 8

Kapitali

- 8.1 Shoqëria tregtare **“PROLAB INTERNATIONAL” SH.P.K.** do të fillojë veprimtarinë e saj me një kapital themeltar prej 100 (njëqind) lekë.
- 8.2 Ky kapital ndahet në mënyrë proporcionale, vlera nominale e të cilave nuk mund të jetë më e vogël se 100 (njëqind) lekë.
- 8.3 Pjesmarrja e ortakëve në Kapitalin e Shoqërisë është në mënyrë proporcionale, në përputhje me kontributin e tyre.

Neni 9

Transferimi i pjesëve të kapitalit

- 9.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - Shit-blerjes;
 - Trashëgimisë;
 - Dhurimit;
 - Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.
- 9.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 10

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

- 10.1 Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë me anë të kontributeve dhe në para dhe në natyrë bëhet me miratimin e Asamblesë së Ortakëve mbi bazën e një projekti të paraqitur nga Eksperti Kontabël i autorizuar.
- 10.2 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- 10.3 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë

Përktheu nga gjuha shqipe në gjuhën turke:

ALTIN KODRA
Përkthyes Zyrtar
Official Translator



Neni 11

Fitimi

- 11.1 Në bazë të kapitalit themeltar të shoqërise fitimi do te ndahet ne menyre te barabarte ne baze te kuotave te kapitalit themeltar te shoqërise.

Neni 12

- 12.1 Shoqëria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te veçanta te financimit për zhvillimin ekonomik dhe tregtar.

Neni 13

- 13.1 Përbërja e kapitalit te shoqërisë, fondet e krijimit te saj si dhe përdorimi dhe rregullimi i çdo fondi te veçante përcaktohen nga organi administrativ sipas te drejtave dhe detyrave te përcaktuara ne statut.
- 13.2 Te ardhurat e përgjithshme te shoqërisë dhe ne përgjithësi çdo operacion financiar i saj do te pasqyrohen ne kontabilitetin e shoqërisë sipas legjislacionit ne fuqi dhe ne mbështetje te akteve përkatëse.
- 13.3 Te ardhurat neto qe do te rezultojnë nga bilanci i miratuar nga Asambleja e Ortakëve do te shpërndahen si vijon: 5% për fondin rezerve deri sa ky fond te arrije 1/5 e kapitalit themeltar, pjesa tjetër përfitohet në mënyrë të barabartë nga Ortakët e Shoqërisë.

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE


Neni 14

Asambleja e Ortakëve

- 14.1 Vendimet kryesore të veprimtarisë së Shoqërisë merren me vendim të Asamblesë së Ortakëve, e cila është organi më i lartë i Shoqërisë, që ka të drejtën të miratojë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e aktivitetit të saj.
- 14.2 Vetëm Asambleja e Ortakëve do të ketë të drejtë të vendos për çështjet e mëposhtme:
- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - modifikimin dhe ndryshimin e këtij Statuti;
 - te vendosë për emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të Shoqërisë;
 - të vendosë për emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - të vendosë për përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
 - të mbikqyr zbatimin e politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - të zmadhojë dhe/ose zvogëlojë kapitalin e regjistruar;
 - vendosë për prishjen, likuidim dhe çdo lloj transformimi tjetër të Shoqërisë;

Përktheu nga gjuha shqipe në gjuhën turke:

ALTIN KODRA
Përkthyes Zyrtar
Official Translator



- i. të themelojë dhe/ose mbyll degë dhe përfaqësi jashtë dhe brenda Shqipërisë;
 - j. të miratojë raportet vjetore dhe bilancet dhe të miratojë shpërndarjen e fitimit;
 - k. të depozitojë padi kundër anëtarëve të organeve të Shoqërisë;
 - l. të vendosë pagën e Administratorit;
 - m. të vendosë mbi organizimin strukturor dhe administrativ të Shoqërisë;
 - n. të vendosë mbi buxhetin vjetor;
 - o. të vendosë marrjen e huave apo dhënien e garancive nga Shoqëria;
 - p. të vendosë për çdo çështje tjetër, që i takon për zgjidhje Asamblesë së Ortakëve, me ligj dhe/ose sipas këtij statuti.
- 14.3 Procesverbalet e mbledhjeve ruhen ne selinë e shoqërisë.

Neni 15

Marrja e Vendimeve

- 15.1 Vendimet në lidhje me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të rregjistruar, shpërndarjen e fitimit, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, Asambleja e ortakëve vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit.
- 15.2 Vendimet e tjera të listuara në nenin 14, përveç atyre të përcaktuara në pikën 14.1 Asambleja e Ortakëve vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Neni 16

Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve

- 16.1 Asambleja e Ortakëve thirret nga administratori, Eksperti Kontabël i Autorizuar.
- 16.2 Asambleja e Ortakëve të shoqërisë thirret të paktën 1 herë në vit.
- 16.3 Lajmërimi bëhet me letër rekomande të paktën 15 dite përpara mbledhjes së asamblesë. Lajmërimi bëhet nga administratori dhe duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës.

Neni 17

Administrimi i Shoqërisë

- 17.1 Shoqëria do të administrohet nga një ose më shumë administratorë, të emëruar nga Asambleja e Ortakëve. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.
- 17.2 Administratorët kanë të drejtë të përfaqësojnë Shoqërinë në mënyrë të plotë për administrimin e zakonshëm të saj si edhe të drejtën për të miratuar të gjitha vendimet që i gjykon të përshtatshme për të arritur dhe përmbushur qëllimin e shoqërisë, me përjashtim të vendimeve që me ligj i takojnë Asamblesë së Ortakëve.
- 17.3 Administratori/ët mund të autorizojë/në palë të treta për ta/t'i përfaqësuar atë/ata në transaksione të veçanta me anë të një prokure të hartuar para noterit.
- 17.4 Të drejtat dhe detyrimet e Administratorëve janë ato të përcaktuara në Ligjin e Shoqërive Tregtare, këtë Statut, vendimet e Asamblesë së Ortakëve dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.

Përktheu nga gjuha shqipe në gjuhën turke:

ALTIN KODRA
Përkthyes Zyrtar
Official Translator



17.5 Administratorë të Shoqërisë janë **Z. Cevat Aybars HEPER** dhe **Z. Yigit KILIÇ**.

17.6 Administratori/ët kanë të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

- a. të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Ortakëve
- b. përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
- c. hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
- d. përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave
- e. nënshkrimin e të gjithë dokumenteve, lëshimin e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
- f. mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënien dhe marrjen e paradhënies;
- g. punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
- h. marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, ngritjen e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratorët mund të udhëzojnë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërblimit të tyre me miratimin paraprak të Asamblesë së Ortakëve;
- i. administratorët kanë të drejtë të ngrenë padi dhe t'i tërheqin ato, të nënshkruajnë marrëveshje gjyqësore, të mbyllin marrëveshje arbitrazhi, të caktojnë arbitra, të tërheqin paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërpresin procedimet por në cdo rast përpara kryerjes së ndonjë prej veprimeve të mësipërme, administratorët duhet të marrin miratimin e Asamblesë së Ortakëve.
- j. ndërmarrjen e të gjithë veprimeve të tjera që i takojnë aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- k. mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e kontabilitetit;
- l. përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga auditorë të jashtëm nëse kjo kërkohet nga ligji ose nga një vendim Asamblesë së Ortakëve;
- m. thirrjen e mbledhjeve të Ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së Ortakëve për shpalljen e vendimeve përkatëse;
- n. të vendosë në dispozicion të Ortakëve të Shoqërisë sa herë që të kërkohet prej tyre informacionet, raportet dhe dokumentet në lidhje me shpenzimet e Shoqërisë, gjendjen e llogarive bankare, inventarin, deklarata për të hyrat, deklarata tjera financiare, fletëparaqitjet tatimore të Shoqërisë dhe auditet, nëpërmjet formës së kërkuar dhe njoftuar nga secili Ortak, si p.sh. nëpërmjet faxit, postës elektronike apo postës së zakonshme.
- o. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

Përktheu nga gjuha shqipe në gjuhën turke:

ALTIN KODRA
Përkthyes Zyrtar
Official Translator



p. cdo detyrë tjetër të parashikuar në ligj.

Neni 18

Përgjegjësitë e Administratorit

- 18.1 Administratorit përgjigjet individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve në rastet e shkeljes së ligjit, statutit ose për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 18.2 Administratori/ët duhet të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi.
- 18.3 Administratori gjatë kryerjes së detyrave të tij përgjigjet ndaj shoqërisë për cdo veprim ose mosveprim, që lidhet me qëllimet e shoqërisë tregtare, përvec rasteve kur në bazë të informacioneve përkatëse veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 18.4 Administratori është i detyruar t'i dëmshpërblirë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse kryen veprimet e mëposhtme;
 - a. u kthen ortakëve kontributet
 - b. u paguan ortakëve interesa apo dividend;
 - c. u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - d. lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjëndjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - e. jep kredi.

Neni 19

Eksperti(ët) Kontabël të Autorizuar

- 19.1 Eksperti Kontabël i Autorizuar do të emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, nëse është e nevojshme.
- 19.2 Eksperti Kontabël ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregëtare të shoqërisë, atë gjithvjetor dhe atë në lidhje me kontrollat periodike të ushtruara prej tij në rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ortakët.
- 19.3 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për kontrollat periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që tja paraqesë e dorëzojë

Neni 20

Viti Financiar

- 20.1 Viti Financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti. Viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 21

Bilanci. Mbajtja e Llogarisë

Përktheu nga gjuha shqipe në gjuhën turke:

ALTIN KOLLA
Përkthyes Zyrtar
Official Translator



- 21.1 Bilanci i Shoqërisë kontrollohet nga Asambleja e Ortakëve dhe duhet të përgatitet për t'ju paraqitur organeve tatimore përpara përfundimit të muajit mars të vitit pasues.
- 21.2 Librat e llogarisë duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe në monedhën vendase (Lek). Shoqëria mund të mbajë llogari të veçanta në monedhë të huaj, shuma e të cilave duhet të konvertohet, çdo muaj, në monedhën vendase.
- 21.3 Shoqëria mund të marrë financime nga institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë arsye Shoqëria mund të vendosë barrë siguroese mbi kuotat si garanci, ose mund të hipotekojë pasurinë e paluajtshme të saj, me vendim të Asamblesë së Ortakëve të marrë me Shumicë të Thjeshtë.

Neni 22

Largimi dhe përjashtimi Ortakut

- 22.1 Largimi dhe përjashtimi i ortakut do të kryhet në përputhje me nenet 101, 102 dhe 103 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 23

Likuidimi

- 23.1 Asambleja e Ortakëve mund të vendosë të prishë Shoqërinë me Shumicë të Cilësuar.
- 23.2 Me vendim të Asamblesë së Ortakëve do të caktohet një likuidues ose një grup likuiduesish që do të merren me procedurat e likuidimit.
- 23.3 Likuiduesi(t) do të përgatisin raportin e likuidimit, i cili përmban një përmbledhje të gjendjes ekonomike të Shoqërisë, hapat e likuidimit dhe kohën e nevojshme për përfundimin e tij. Në fund të këtij procesi, Asambleja e Ortakëve do të kontrollojë bilancin përfundimtar dhe do të japë miratimin për përfundimin e procedurës së likuidimit.

Neni 24

Ndryshimet në Statut

- 24.1 Dispozitat e këtij Statuti mund të ndryshohen nga Asambleja e Ortakëve, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 25

Dispozita Përfundimtare

- 25.1 Ky Statut hartohet dhe nënshkruhet në 5 (pesë) kopje origjinale në gjuhën shqipe, secila prej tyre me të njëjtën vlerë ligjore.

ORTAKËT E SHOQËRISË

“PROLAB INTERNATIONAL” SH.P.K.

Cevat Aybars HEPER

Cevat Aybars Hepar

Z. Yigit KILIÇ

Yigit Kiliç

Përktheu nga gjuha shqipe në gjuhën turke:

ALTIN KODRA
Përkthyes Zyrtar
Official Translator

Altin Kodra

Z. Yigit Kiliç